

**HEWLETT PACKARD I.T. BV**  
**Dega ne Shqiperi**

Pasqyrat Financiare te Audituar

Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2015

---

## PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
1. INFORMACION I PERGJITHSHEM	5
2. POLITIKAT KONTABEL	5
2.1 BAZAT E PERGATITJES	5
2.2 PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL	5
2.3 NDRYSHIMET NE POLITIKAT KONTABEL DHE SHENIMET SHPJEGUESE	9
3. PERDORIMI I VLERESIMEVE DHE GJYKIMEVE	9
4. STANDARDET E LESHUARA POR ENDE JO EFEKTIVE DHE JO TE MIRATUARA	10
5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	11
6. SISTEMI KONTABEL	12
8. INVENTARI	13
9. TE ARKETUESHME NGA KLIENTET	13
10. TE ARKETUESHME NGA PALET E LIDHURA	13
11. TE TJERA TE ARKETUESHME	14
12. MJETE MONETARE	14
13. TE ARDHURA TE SHTYRA	14
14. TE TJERA DETYRIME AFATGJATA	15
15. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE	15
16. TE PAGUESHME NDAJ PALEVE TE LIDHURA	15
17. DETYRIME TATIMORE	15
18. SHITJE MALLRASH	16
19. SHITJE SHERBIMI	16
20. KOSTO MATERIALESH	16
21. SHPENZIME ADMINISTRATIVE	17
22. KOSTO PERSONELI	17
23. HUMBJE NETO PREJ NDRYSHIMIT TE KURSIT TE KEMBIMIT	17
24. SHPENZIMI I TATIM FITIMIT	18
25. ANGAZHIME DHE DETYRIME TE MUNDSHME	18
26. NGJARJE PAS MBYLLJES SE BILANCIT	18
27. MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	19

## **RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR TË "HEWLETT PACKARD I.T. BV" - Dega në Shqipëri**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "HEWLETT PACKARD I.T. BV" Dega në Shqipëri (më poshtë "Dega"), që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për këtë vit ushtrimor, pasqyrën e fluksit të parasë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe të tjera shënime sqaruese.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimeve.

### **Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur**

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumën dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë të kualifikuar.

### **Baza për opinionin e kualifikuar**

1. Siç përshkruhet në shënimin 19 të pasqyrave financiare, Dega ka njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse të ardhura që vijnë nga shërbime kontraktuale në vlerën e LEK 52,247,312, të cilat lidhen me shërbime që shtrihen në një afat kohor më të gjatë se 1 vit. Sipas të dhënave të Degës, një vlerë prej LEK 34,229,155 lidhet me shërbime të cilat duhet të ofrohen pas dates 31 dhjetor 2015. Në vijim të vendimit të Drejtimit për të likuiduar vullnetarisht Degën në Shqipëri, kjo e fundit ka njohur shumën prej LEK 34,229,155 si të ardhura të vitit 2015, duke transferuar pa pagesë detyrimin për përmbushjen e shërbimit tek HP Enterprise (Mëma). Në përputhje me SNRF kjo shumë duhet të shtyhej dhe të njihej si detyrim i Degës më 31 dhjetor 2015.

### **Baza për opinionin e kualifikuar (vazhdim)**

2. Siç përshkruhet në shënimin 21 të pasqyrave financiare, Dega ka regjistruar një shpenzim që lidhet me shpenzime që HP Enterprise (Mëma) ka marrë përsipër për të siguruar vijimësinë e aktiviteteve të lidhura me HP në Shqipëri dhe në Kosovë, në kohën kur Dega të nisë likuidimin. Për qëllim të përgatitjes së pasqyrave financiare ligjore, Dega e konsideron këtë shpenzim të vitit financiar duke qenë se fatura e blerjes i është lëshuar Degës, por në bazë të evidencave, përfitimi ekonomik i këtij shpenzimi i shkon Mëmës. Sipas kuadrit të përgatitjes së pasqyrave financiare, shpenzimi duhet të ishte njohur te entiteti që përfiton të mirat ekonomike dhe si rrjedhojë shpenzimet administrative të Degës për vitin ushtrimor dhe detyrimet ndaj Mëmës do uleshin me LEK 10,204,049, ndërsa fitimi neto i periudhës do të rritej me të njëjtën vlerë.

### **Opinion i kualifikuar**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të diskutuara në paragrafin "Baza për opinionin e kualifikuar" më lartë, pasqyrat financiare të Degës japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Degës më 31 dhjetor 2015 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### **Theksim i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen ndaj shënimit 2.1 të pasqyrave financiare, që thekson faktin se Dega së shpejti do të nisë procesin e likuidimit dhe të dhënat kontabile janë përgatitur duke përdorur një bazë të ndryshme nga ajo e vijimësisë. Të dhënat kontabile janë përgatitur duke përdorur këtë bazë kontabilizimi duke qenë se Dega pret të nisë likuidimin brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Opinioni ynë nuk kualifikohet në lidhje me këtë çështje.

**Ernst & Young Ekspert Kontabël të Autorizuar  
Dega në Shqipëri**

*Ernst & Young Certified Auditors*  
18 mars 2016  
Tiranë, Albania

**Mario Vangjel  
Ekspert Kontabël i Autorizuar**

*Mario Vangjel*

HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR  
me 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015 në LEK	31 dhjetor 2014 në LEK
<b>Aktivet</b>			
<b>Aktive afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	7	-	399,146
		-	<b>399,146</b>
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Aktive të mbajtura për shitje		5,517	-
Inventari	8	-	30,378,235
Te arketueshme nga klientet	9	16,509,404	27,922,434
Te arketueshme nga palet e lidhura	10	-	6,799,873
Te tjera të arketueshme	11	1,389,905	6,197,787
Mjete monetare	12	264,326,158	224,209,673
		<b>282,230,984</b>	<b>295,508,002</b>
<b>Totali aktiveve</b>		<b>282,230,984</b>	<b>295,907,148</b>
<b>Kapitali dhe pasivet</b>			
<b>Kapitali</b>			
Fitimet e pashperndara		237,736,956	187,272,908
Fitim i vitit financiar		38,376,191	50,464,048
<b>Total kapitali</b>		<b>276,113,147</b>	<b>237,736,956</b>
<b>Pasive afatgjata</b>			
Te ardhura të shtyra	13	-	40,320,980
Te tjera detyrime afatgjata	14	-	4,494,088
		-	<b>44,815,068</b>
<b>Pasive afatshkurtra</b>			
Te pagueshme ndaj furnitoreve	15	1,185,409	5,283,117
Te pagueshme ndaj Paleve të lidhura	16	4,903,612	4,086,137
Te pagueshme të tjera		-	98,809
Detyrime tatimore	17	28,816	3,887,061
		<b>6,117,837</b>	<b>13,355,124</b>
<b>Totali pasiveve</b>		<b>6,117,837</b>	<b>58,170,192</b>
<b>Totali kapitalit dhe pasiveve</b>		<b>282,230,984</b>	<b>295,907,148</b>

Pasqyrat financiare nga faqja 1 to 21 u firmosën dhe u aprovuan më 12 shkurt 2016 prej:

Lukas Najman  
Administrator



Irida Jaho  
Financiere

Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.

**HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri**

**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**  
**per ushtrimin e mbyllur me 31 dhjetor, 2015**

		Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
	Shenime	ne LEK	ne LEK
<b>Aktiviteti i vazhdueshem</b>			
Shitje mallrash	18	37,968,197	15,474,553
Shitje sherbimi	19	86,311,327	85,493,643
<b>Te ardhura</b>		<b>124,279,524</b>	<b>100,968,196</b>
Kosto materialesh	20	(43,047,462)	(22,743,233)
<b>Fitimi bruto</b>		<b>81,232,062</b>	<b>78,224,963</b>
Te ardhura te tjera		-	-
Shpenzime administrative	21	(41,324,909)	(31,040,897)
Kosto personeli	22	(10,038,782)	(7,330,579)
Shpenzime amortizimi		(82,373)	(69,044)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>29,785,998</b>	<b>39,784,443</b>
Kosto financiare		(284,831)	(287,443)
Humbje prej ndryshimit te kursit te kembimit, neto	23	18,196,879	22,046,184
<b>Fitimi perpara tatimit prej aktivitetit te vazhdueshem</b>		<b>47,698,046</b>	<b>61,543,184</b>
Shpenzim tatim fitimi	24	(3,823,336)	(11,392,445)
E ardhur tatimore e shtyre	11	(5,498,519)	313,309
<b>Fitimi i vitit prej aktivitetit te vazhdueshem</b>		<b>38,376,191</b>	<b>50,464,048</b>

*Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.*

**HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri**

**PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË**  
per ushtrimin e mbyllur me 31 dhjetor, 2015

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015 ne LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 ne LEK
<b>Fluksi i parase nga aktiviteti i shfrytezimit</b>		
<b>Fitimi perpara tatimit</b>	47,698,046	61,543,184
Rregullime per:		
Amortizimi	82,373	69,044
Humbje nga kursi i kembimit	(18,196,879)	(22,048,718)
Humbje nga shitja e asetëve fikse	370,006	-
Akrualet	788,826	-
(Zvogelim)/Rritje e te arketueshmeve	27,103,700	(18,086,256)
(Zvogelim)/Rritje e inventarit	30,319,485	6,196,404
(Zvogelim)/Rritje e te pagueshmeve	(58,171,331)	(5,675,512)
Mjete monetare te perfituara nga aktiviteti i shfrytezimit	<b>29,994,226</b>	<b>21,998,146</b>
Tatim fitim i paguar	(7,943,262)	(5,621,740)
<b>Mjete monetare neto te perfituara nga aktiviteti i shfrytezimit</b>	<b>22,050,964</b>	<b>16,376,406</b>
<b>Fluksi i parase nga aktiviteti investues</b>		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	-	(460,833)
Mjete monetare nga shitja e aktiveve afatgjata	-	-
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti investues</b>	-	<b>(460,833)</b>
<b>Fluksi i parase nga aktivitetet financuese</b>		
Mjete monetare nga hua afatgjate	-	-
Pagesa te detyrimeve qiramarrese	-	-
Dividente te paguar	-	-
<b>Mjete monetare neto nga aktiviteti financues</b>	-	-
<b>Rritja neto e mjeteve monetare</b>	<b>22,050,964</b>	<b>15,915,573</b>
Mjetet monetare me 1 janar	224,209,673	187,446,471
Ndryshimi nga kursi i kembimit	18,065,521	20,847,629
<b>Mjetet monetare me 31 dhjetor</b>	<b>264,326,158</b>	<b>224,209,673</b>

*Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.*

## HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri

### PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL per ushtrimin e mbyllur me 31 dhjetor, 2015

	<u>Fitimet e pashperndara ne LEK</u>	<u>Totali kapitalit ne LEK</u>
<b>Gjendje me 1 janar 2014</b>	<b>187,272,908</b>	<b>187,272,908</b>
Fitimi neto per periudhen	50,464,048	50,464,048
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen</b>	<b>50,464,048</b>	<b>50,464,048</b>
Dividente te paguar	-	-
<b>Gjendje me 31 dhjetor 2014</b>	<b>237,736,956</b>	<b>237,736,956</b>
Fitimi neto per periudhen	38,376,191	38,376,191
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Totali i te ardhurave gjithepershires per periudhen</b>	<b>38,376,191</b>	<b>38,376,191</b>
Dividente te paguar	-	-
<b>Gjendje me 31 dhjetor 2015</b>	<b>276,113,147</b>	<b>276,113,147</b>

*Shënimet shpjeguese përbëjnë një pjesë të pandarë të këtyre pasqyrave financiare.*



## **HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri**

### **Shënime të pasqyrave financiare për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor, 2015**

*(të gjitha vlerat janë në lek, përveç në rastet kur shprehen ndryshe)*

#### **1. Informacion i përgjithshëm**

Hewlett-Packard I.T. BV Dega e Shqipërisë është Dege e Hewlett-Packard International Trade B.V., shoqëri e regjistruar në Dhomen e Tregtisë të Amsterdimit, Hollandë. Dega është regjistruar në Shqipëri me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës me numër të regjistrimit tregtar Nr.36386 dhe datë 24 tetor 2006.

Aktiviteti kryesor i Degës është tregtimi i mallrave të Teknologjisë Informatike, shërbime që lidhen me këto mallra, asistencë teknike si dhe shërbime mirembajtjeje. Administratori i degës është Z. Lukas Najman.

Në 31 dhjetor 2015 Dega ka 0 (zero) punonjës (31 dhjetor 2014: 1 punonjës). Zyra e regjistruar ndodhet në Rrugën "Rr "Themistokli Gërmenji" P. Hekla, SH1, Tiranë. Dega është e regjistruar si person juridik në Tiranë me NIPT K62405008G.

Pasqyrat financiare të Degës për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë miratuar nga Administratori i degës më 12 shkurt 2016.

#### **2. Politikat kontabel**

##### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat Financiare janë përgatitur të gjithë aspektet materiale, në përputhje me ligjin Nr 9228 datë 29 prill 2004 "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Deri më 31 dhjetor 2014, pasqyrat financiare të degës së u prezantuan mbi parimin e vazhdueshmerisë. Në gusht 2015, Bordi i Drejtoreve të kompanisë mëmë ka vendosur të fillojë likuidimin e Degës. Prandaj, parimi i vazhdimësisë nuk është më i përshtatshëm dhe më 31 dhjetor 2015 Dega i ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të likuidimit.

Te dhenat e pasqyrave financiare të vitit korrent dhe ato krahasuese janë të shprehura në LEK, që është dhe monedha raportuese dhe funksionale e Degës.

Dega ka për qëllim të nisë procedurat e likuidimit Brenda muajit mars 2016.

##### **2.2 Përmbledhje e politikave kontabel**

###### **a. Transaksionet në valute të huaj**

Pasqyrat financiare të Degës janë paraqitur në Lek. Dega e ka përcaktuar si monedhën e saj funksionale dhe zerat e pasqyrave financiare janë matur duke përdorur këtë monedhë.

###### **(i) Transaksionet dhe balancat**

Transaksionet në monedhën e huaj regjistrohen fillimisht nga Dega me kurset e këmbimit funksionale ditore respektive në datën me të parë që njihet transaksioni. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të emëruara në monedhë të huaj konvertohen perseri me kursin e këmbimit funksional në datën e raportimit. Të gjitha diferencat që vijnë prej mbylljes ose konvertimit të zerave monetare reflektohen në pasqyrën e të ardhurave.

**2.2 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

**a. Transaksionet ne valute te huaj (vazhdim)**

**(i) Transaksionet dhe balancat (vazhdim)**

Zerat jomonetare te cilat perllogariten me kosto historike ne monedhe te huaj, konvertohen duke perdorur kurset e kembimit te datave te transaksionit fillestar. Zerat jomonetare te cilat njihen me vleren e drejte, ne monedhe te huaj, konvertohen duke perdorur kurset e kembimit ne daten kur percaktohet vlera e drejte. Humbja ose fitimi qe del nga konvertimi i zerave jomonetare trajtohet ne te njejten menyre si njohja e humbjes ose fitimit nga ndryshimi i vleres se drejte te zerave te bilancit (psh konvertimi i diferencave ne zera te cilave u njihet humbja ose fitimi ne pasqyren e te ardhurave gjithperfshirese, respektivisht)

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
1 EUR	137.28	140.14
1 USD	125.79	115.23

**b. Njohja e te ardhurave**

Te ardhurat njihen me vleren e perfitimeve te ardhshme ekonomike qe do te hyjne ne Dege dhe keto perfitime mund te maten konkretisht pavaresisht se kur kryhen pagesat. Kostot njihen ne pasqyren e te ardhurave kur ndodhin (dhe jo domosdoshmerisht kur jane bere pagesat). Te ardhurat dhe kostot regjistrohen ne pasqyrat financiare te periudhes te ciles i perkasin.

**c. Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatim fitimit perbehet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyre. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyre njihen ne humbje ose fitim pervec se kur ajo lidhet me zerat te cilat njihen direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjithperfshirese.

***Tatimi fitimi aktual***

Tatimi aktual eshte perllogaritje e tatim fitimit te pagueshem mbi te ardhurat e tatueshme per vitin, duke perdorur shkallen tatimore ne fuqi ne daten e raportimit, dhe ndonje sistemim ne pagesat e tatimeve ne lidhje me vitet e kaluara.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore per kete periudhe perllogariten ne vleren e pritshme qe do te kompensohet ose do t'i paguhet autoriteteve tatimore. Norma tatimore dhe legjislacioni tatimor i perdorur per te llogaritur vlerat jane ato nga te cilat jane ne fuqi, ne daten e raportimit ne Shqiperi.

Tatim fitimi aktual lidhur me zera te cilat njihen direkt ne kapital njihet ne kapital dhe jo ne pasqyren e te ardhurave. Menaxhimi ne menyre periodike vlereson pozicionin e mbajtur ne kthimet tatimore sipas situatave ne te cilat rregulloret e tatimit te aplikueshem jane subjekt i interpretimeve dhe vendos provizone aty ku eshte e pershtatshme.

***Tatimi mbi fitimin i shtyre***

Tatimi i shtyre rrjedh nga perdorimi i metodes se detyrimeve mbi diferenca te perkohshme midis bazes se tatueshme te aktiveve dhe pasiveve, dhe pagesave te tyre per qellime te raportimit financiar ne daten e raportimit.

## **2.2 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

### **c. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Detyrimet e tatimit të shtyre njihen për të gjitha diferencat e perkohshme të tatueshme, përveç:

- Kur detyrimi i tatimit të shtyre del nga njohja fillestare e emrit të mirë ose një aktivi ose një detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim operacional dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitimin kontabel as fitimin ose humbjen e tatueshme.
- Në lidhje me diferencat e perkohshme të tatueshme të lidhura me investime në filiale, shoqëri dhe interesa në sipërmarrje të përbashkëta, kur koha e ndryshimit të diferencave të perkohshme mund të kontrollohet dhe është e mundur që këto diferencat të mos kthehen në periudha të ardhshme.

Vlera kontabel e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet deri në atë vlerë që nuk është më e mundur që fitimi i tatueshem do të jetë i mjaftueshem të jetë disponibel për të lejuar teresisht ose pjesërisht përdorimin e tatimit të shtyre. Aktivet tatimore të panjohura rivelesohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në atë vlerë që do të jetë e mundur për të mbuluar aktivet tatimore të shtyra në fitimet e tatueshme të viteve të ardhshme.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra përlogariten sipas normës tatimore që pritet të aplikohet në vitin kur realizohet aktivi ose percaktohet detyrimi, bazuar në normat tatimore (ose legjislativën tatimore) që është në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyre që lidhet me zërat të cilat njihen jashtë fitimit ose humbjes do të njihet jashtë fitimit ose humbjes. Zërat e tatimit të shtyre njihen për transaksionet përkatëse ardhurat gjithëpërfshirëse ose direkt në kapital.

Aktivitet dhe pasivitet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme juridike për të kompensuar aktivitet e tatueshme kundrejt detyrimeve të tatimit aktual dhe tatimi i shtyre kundrejt të njëjtit subjekt të tatueshem dhe të njëjtit autoritet tatimor.

### **d. Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale**

#### **Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale përlogariten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin e akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen drejtperdrejtë me blerjen e një aktivi. Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale kanë jete të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen veçmas si aktive afatgjatë materiale. Fitimi dhe humbja nga pakesimi i një zëri të aktiveve afatgjatë materiale percaktohet duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabel të aktiveve afatgjatë materiale, dhe njihen me vlerën neto tek të ardhurat e tjera në pasqyrën e të ardhurave.

#### **Kostot vijuese**

Kosto për zëvendësimin e një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet me vlerën kontabel të zërit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike do të hyjnë në Dege, dhe kostot e saj mund të maten konkretisht. Vlera kontabel e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Kostot e mirembajtjes së përditshme të aktiveve afatgjatë materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin. Kur pjesë të rëndësishme të aktiveve afatgjatë materiale kerkohet të zëvendësohen me intervale, Dega njihet pjesët e tilla si aktive individuale me jete të dobishme specifike dhe i amortizon ato individualisht. Në të njëjtën mënyrë, kur behet një kontroll i përgjithshëm, kostot e tij njihen në vlerën kontabel të aktiveve afatgjatë materiale, si zëvendësim nëse kriteret e njohjes përmbushen. Të gjitha kostot e tjera të riparimeve dhe mirembajtjes njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

## HEWLETT PACKARD I.T. BV – Dega në Shqipëri

### Shënime të pasqyrave financiare për ushtrimin e mbyllur më 31 dhjetor, 2015

(të gjitha vlerat janë në lek, përveç në rastet kur shprehen ndryshe)

#### 2.2 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)

##### d. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)

###### Amortizimi

Normat vjetore të amortizimit të përdorura, bazuar në Udhezimin e Ministrisë së Financave nr. 5 datë 30 janar 2006 janë si më poshtë:

Aktivet Materiale	Norma e Zhvleresimit %		Baza e perlllogaritjes
	2015	2014	
Makineri e Pajisje	20	20	Mbi vlerën e mbetur
Materiale Zyre	20	20	
Pajisje elektronike	25	25	

Vlera e mbetur e aseteve, jeta e dobishme dhe metodat e amortizimit rishikohen çdo vit financiar dhe rregullohen prospektivisht, nëse është e pershtatshme.

Aktivët jomateriale njihen nëse parashikohet që Dega të ketë përfitime të ardhshme ekonomike që kanë lidhje me këto aktive dhe kosto e aktivitetit mund të matet në mënyrë të besueshme.

##### e. Inventari

Inventari është vlerësuar me vlerën me të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot për të sjellë inventarin në gjendje dhe vendin përkatës janë kontabilizuar në bazë të faturave të blerjes kurse shpenzimet e përgjithshme të lidhura me inventarin janë shpërndarë duke përdorur mesataren e ponderuar.

Vlera neto e realizueshme përcaktohet nga cmimi shitjes minus kostot e parashikuara për të shitur inventarin.

##### f. Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në dorë dhe para të depozituara në banke, investime afatshkurtra likuide, me maturitet tre muaj ose më pak, vlera e drejte e të cilave nuk ndryshon shumë dhe menaxhohen nga Dega në likuidimin e angazhimeve afatshkurtra.

##### g. Llogari, kërkesa të arketueshme dhe të pagueshme ndaj furnitoreve

Kliente të furnitoreve paraqiten në bilanc me vlerën e fatures origjinale dërguar klientit ose marrë nga furnitori minus provizionin e lidhur me to. Provizioni për demin e arketueshme tregtare vendoset kur ka evidence objektive që Dega nuk do të jete në gjendje të mbledhe të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të llogarive të arketueshme. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të hyjë në falimentim ose riorganizime financiare, dhe vonesa në pagesat konsiderohen si tregues të llogarisë së arketueshmeve tregtare të demtuar.

Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabel dhe shumës së rikuperueshme, e cila është vlera aktuale e flukseve të ardhshme minus normën e interesit të tregut për huamarrje të ngjashme.

## **2.2 Permbledhje e politikave kontabel (vazhdim)**

### **h. Benefite pas largimit nga puna dhe skema pensionesh**

Dega paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetësor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni lokal mbi sigurimet shoqërore. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtare përgjegjëse për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka detyrime të tjetra shtese në lidhje me fondin për pensione.

### **i. Zera jashtë bilancit**

Zerat e rrëgjistruara jashtë bilancit reflektojnë kontrata (pa transferime parash) mes Degës dhe institucioneve financiare. Me se shumti të tilla zotime lidhen me zotime financiare ose garanci. Ato përfaqësojnë një detyrim bankar për të bërë dicka gjatë ose brenda një periudhe të caktuar kohore. Keto zotime regjistrohen kur detyrimi lind. Shuma për t'u regjistruar jashtë bilancit përputhet me shumën e garantuar ose me shumën e zotuar të cilesuar në kontratë. Në datën e maturimit regjistrimi kthehet mbrapsht.

## **2.3 Ndryshimet në politikat kontabel dhe shenimet shpjeguese**

### **Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara**

Politikat kontabel të adaptuara janë në përputhje me ato të vitit të kaluar përveç interpretimeve bashkëgjitur të SNRF të cilat janë adaptuar nga Dega më 1 janar 2015:

- **Ndryshime në SNK 19 skema përfitimesh të percaktuara: Kontributet e punonjësve**
- **SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione**
- **SNRF 3 Kombinimet e biznesit**
- **SNRF 8 Segmentet e shfrytëzimit**
- **SNK 16 Toka, Ndertesa, Makineri e Paisje dhe SNK 38 Aktivitet Jo-materiale**
- **SNK 24 Dhenia e informacioneve shpjeguese për palet e lidhura**
- **SNRF 13 Matja me vlerën e drejte**
- **SNK 40 Investimet në pasuri**

Asnjë prej këtyre standardeve dhe interpretimeve të reja ose të ndryshuara nuk ndikon në pasqyrat financiare të Degës së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015.

## **3. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabel dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga keto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato kanë efekt.

Informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabel që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare është i përfshirë në cdo shënim përkatës.

### **3. Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve (vazhdimi)**

#### **a. Vleresimi i vazhdimesise**

##### **Pasqyrat financiare – Parimi i jo-vazhdimesise**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në baze të parimit të jovazhdimesise. Dega pritët të fillojë procesin e likuidimit gjatë 3 muajve të parë të vitit 2016. Informacionet shpjeguese specifike janë përgatitur për trajtimin e aktiveve afatgjata dhe detyrimeve afatgjata (shenimi 3.b) dhe detyrimeve kontigjente (shenimi 3.c).

#### **b. Aktivët dhe Pasivët**

Aktivët e qëndrueshme vlerësohen me vlerën e tyre kontabel, i cili vlerësohet të jetë e përafërt me vlerën e rikuperueshme të këtyre aktiveve nga shitja e tyre në të ardhmen. Të gjitha aktivët janë të klasifikuar si aktive afatshkurter dhe të gjitha pasivët klasifikohen si pasive aktuale.

#### **c. Detyrimet tatimore**

